



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHITËTËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Komuna e Kisella Vodës

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë për vitin 2021

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa aktivitetet dhe transaksionet që reflektohen janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- mos harmonizimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Sektorin për revizion të brendshëm në pajtim me kërkesat ligjore;
- nuk janë evidentuar kërkesat në bazë të kompensimeve për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje në evidencën e kontabilitetit;
- mos respektimi i detyrës për mbajtjen e regjistrit për miratimet e dhënë për vendosjen e pajisjeve urbane dhe miratimin e programit vjetor për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane.

Mendimi i dhënë *:

Shprehëm mendim me rezervë për realitetin dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (630) për vitin 2021 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

- harmonizimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Sektorin për revizion të brendshëm në pajtim me kërkesat ligjore;
- përcaktimi real i bazës së ekzistimit të kërkesave, evidentimi adekuat i tyre në librat afariste dhe mundësi për arkëtimin e tyre;
- administrimi i tatimeve komunale për shfrytëzimin e hapësirës para hapësirave afariste, vendosjen e regjistrit për miratimet e dhëna për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe pajisjeve urbane dhe mbikëqyrje inspektuese të tyre.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Dobësi në Ligjin për tatimet komunale te numrat tariferor 9 dhe 10 tatimi komunal për shfrytëzimin e rrugicave dhe rrugëve dhe mirëmbajta e ndriçimit publik.

Dobësi në Ligjin për tatimet e pronës për harmonizimin e gjendjes së regjistrit të patundshmërive të komunave me regjistrin të cilën e mbanë AKP-ja e RMV-së.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

/

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin për llogarinë e buxhetit themelor (630) për vitin 2021.

*  pozitive,  me rezervë,  të pavolitshëm,  të përmbajtur